



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Nr. 567/B prot.

B.Curri, më 30 . 07 . 2026

Lenda : Dergim Projekt Vendim “Per Nje Shtese Ne Vkb Nr. 38 Te Dates 04.07.2025, Për Vendosjen E Kufizuesve Te Shpejtesise Ne Rruget E Bashkise.”

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Tropoje

Te nderuar Keshilltare po iu dergojme Projekt Vendimin dhe relacionin shpjegues “Per nje shtese ne Vkb nr. 38 te dates 04.07.2025, për vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rruget e bashkise” konkretisht per vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rrugen “Azem Hajdari” , fshatin Margegaj, Njesia Administrative Margegaj.

Bashngjitur kesaj shkrese do te gjeni :

- | | |
|---|--------|
| - Projekt Vendim | 1 faqe |
| - Relacion shpjegues | 1 faqe |
| - Preventiv | 1 faqe |
| - Harte shpjeguese | 1 faqe |
| - Kerkese te kryeplakut te fshatit Margegaj | 1 faqe |

KRYETARI I BASHKISE TROPOJË

Rexhë BYBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

Nr. 567/1 prot.

B.Curri, më 30 . 01. 2026

P/ VENDIM

Nr _____ Datë _____ . 01. 2026

PER NJE SHTESE NE VKB NR. 38 TE DATES 04.07.2025, PËR VENDOSJEN E KUFIZUESVE TE SHPEJTESISË NE RRUGET E BASHKISË.

Mbështetur në **Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”**, i ndryshuar, Ligjit 44/ 2015, “Kodi i Procedures Administrative te Republikës se Shqiperise”, Ligjit Nr. 8378, date 22. 07. 1998, “Kodi Rrugor i Republikës se Shqiperise”, ne baze te vendimit te keshillit bashkiak nr.38 date 07.07.2025 dhe te kerkeses se vazhdueshme te banoreve te fshatit Margegaj me se fundmi me nr. 567 Prot. date 28 . 01 .2026 , dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tropojë në mbledhjen e datës ____ . 01. 2026:

VENDOSI

1) Te shtoje ne pike nr.1 ne rrugen “Azem Hajdari” ne fshatin Margegaj vendosjen e 2 kufizuesve te shpejtesise (bumave) sipas standarteve te percaktuare teknike dhe bashkkohore.

2) Me zbatimin e këtij vendimi si dhe me percaktimin e plotesimit te kerkesave te tjera, te mundeshme, ngarkohen, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Drejtoria e Sherbimeve, Drejtoria Ekonomike, dhe Policia Bashkiake.

3)Ky vendim hyn sipas nenit 55 pika 6 te ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

Per DPZHT- ne:

Pergjegjesi i DPZHT-se Endrit Musaj

Drejtori i DPZHT-se Egzon Muhametaj

Ligjshmeria:

KRYETARI I BASHKISË TROPOJË

Rexhë BYBERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 567/12 Prot.

B. Curri, më 20 01. 2026

Lënda: RELACION.


Per: Vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rrugen "Azem Hajdari" , fshatin Margegaj

Të nderuar Këshilltarë!

Nisur nga kërkesat e shumta te banoreve te fshatit Margegaj , te Njesise Administrative Margegaj për të propozuar vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë ne segmentin rrugore konkretisht ne pjesen e fillimit te rruges "Azem Hajdari" deri tek kabina elektrike qe eshte nen administraten e Bashkise Tropoje referuar dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar paraqesim parajush propozimin e vendosjes se dy kufizuesve te shpejtesise sipas hartes perkatese.

Kufizuesit e parashikuar janë të llojit me asfalt (ku futet dhe sinjalizimi i rruges) të cilët nuk përbëjnë rrezik për përdoruesit e rrugës, përkundrazi do të shërbejnë si masa parandaluese ndaj aksidenteve rrugore.

Prandaj per realizimin e bumeve ne rruge duhet te behet realizohet me asfalt dhe kane nevojë per 364,659.52 leke me TVSH



Duke ju falënderuar për vëmendjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin, kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi në funksion të përmirësimit të sigurisë rrugore në territorin e Bashkisë Tropojë.

Faleminderit !'

Drejtorja e PZHT-se.

E. Musaj

E. Muhametaj



PREVENTIV

Objekti: Pnumet per realizimin u kufizuesve te shpejtesise ne rruget ne njesine Margegaj sipas kerkeses se fshatit Margegaj , Bashkia Tropoje

Nr.	Nr.Aanliz.	Emertimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
I. PUNIME TE NDRYSHME						
1	4.190	Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	ml	20	230.03	4600.60
2	3.226/4	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 7cm, me makineri	m2	24	2,024.70	48592.80
3	3.969/1	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m2	m2	24	231.07	5545.68
4	3.946/2	Vijeziomet e kalimit te kembesoreve. Akrelike	m2	24	926.48	22235.52
5	3.936/1	F.V. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	4	15,932.89	63731.56
		Shuma				144,706.16
		SHUMA PER 2 BUMA				289,412.32
		Fonde Rezerve 5%				14,470.62
		Shuma Pa TVSH				303,882.94
		T.V.SH. 20%				60,776.59
		Shuma Me TVSH				364,659.52

Ky preventiv u realizua ne baze te Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Hartoi

GRUPI I PUNES

Ing.Egzon Muhametaj

Ark. Urb. Endrit Musaj

MIRATO I
KRYETARI I BASHKISE
Rexhe BYBERI





Qendra Shëndetësore Murgësi

Varezat e Mangësit

Kufizues Shpejtesie nr.2

Kufizues Shpejtesie nr.1

Image © 2026 Airbus

189 m

Sele Vohodis
dt. 20.01.2026
[Signature]

Nr 567/26
Dt 28/1/2026

Date 28.01.2026

Drejtuar : Bashkise Tropoje

I nderuar Z. Kryetar,

Ne, banorët e fshatit **Margegaj**, nëpërmjet kësaj shkrese po ju drejtohem me kërkesën tonë për **vendosjen e dy (2) kufizuesve të shpejtësisë (bumpe)** në rrugën "**Azem Hajdari**", konkretisht në segmentin nga fillimi i rrugës deri në zonën pranë kabinës elektrike.

Ky segment rruge është mjaft i frekuentuar çdo ditë nga automjete të ndryshme, ndërkohë që në këtë zonë lëvizin vazhdimisht **këmbësorë, fëmijë, të moshuar dhe banorë të lagjes**, çka e bën qarkullimin me shpejtësi të lartë një rrezik real për sigurinë e tyre. Në mungesë të masave kufizuese, janë konstatuar raste të përsëritura të tejkalimit të shpejtësisë, duke rritur ndjeshëm mundësinë e aksidenteve rrugore.

Vendosja e dy kufizuesve të shpejtësisë në këtë segment do të shërbente si një **masë parandaluese dhe mbrojtëse**, duke ulur shpejtësinë e mjeteve, përmirësuar sigurinë rrugore dhe garantuar një mjedis më të sigurt për komunitetin tonë.

Duke vlerësuar angazhimin tuaj për rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve, shpresojmë që kërkesa jonë të merret në konsideratë dhe të trajtohet me prioritet.

Ju falënderojmë për vëmendjen dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,

kryeploku i fshatit.

Glez Ali Almye
[Signature]